



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. _____ Prot

Datë 22/05/2024

PROCES VERBAL

Konsultimi mbi Shfrytëzimin Inteligent të Energjisë

Vendi : Qendra Kulturore Multifunkionale, Përmet

Ora : 11:00

Tema e konsultimit : Përdorimi i energjisë inteligjente

I mbajtur sot më datë 22 Maj në sallën e konferencës pranë Qendrës Kulturore Multifunkionale. Të pranishëm në këtë takim janë : Eksperti i SEMP z. Besim Islami dhe ekipi i tij, punonjës të sektorëve të ndryshëm në Bashki si dhe nxënës të shkollës 9-vjeçare publike “Nonda Bulka” Përmet.

Takimi u hap nga **z. Islami** i cili falenderoi gjithë aktorët e përfshirë në hartimin e këtij plani mjaft të rëndësishëm. Më pas bëri një përshkrim të shkurtër të historikut të zhvillimit të projekteve lidhur me energjinë inteligjente në vendin tonë që nga viti 2016. Gjithashtu tregoi se ky projekt zhvillohet vetëm në 4 bashki dhe duhet përkushtim dhe seriozitet që të vazhdojmë më tej në fazën e dytë.

Më pas eksperti foli më gjerë për Strategjitë e Energjisë dhe kryesisht për Energjinë Eficente, e cila është kyçe në projektin që po zhvillohet aktualisht në Bashkinë Përmet. Ai tregoi disa të dhëna lidhur me shpenzimin e energjisë në shtëpi, shkollë, institucione e me rradhë. Gjithashtu **z. Islami** insistoi fortë në kursimin e energjisë nga të gjithë banorët dhe në përdorimin sa më eficient të saj për të plotësuar nevojat tona.

Ai vijoi duke u treguar se duke përdorur energjinë inteligjente do të kursejmë më shumë dhe këto para do të investohen diku tjetër për të mirën e qytetit.

Fjalën më pas e mori **zj. Etleva Kreci** e cila i tregoi gjithë të pranishmëve se Bashkia së bashku me stafin e saj bëjnë një punë të përditshme mbi këtë projekt. Gjithashtu ajo paraqiti një të dhënë mjaft të rëndësishme ku Bashkia konsumon vetëm 6% të totalit të energjisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

së konsumuar në qytetin e Përmetit. Më pas tha se më rritjen e përdorimit të energjisë eficiente do të ketë një ulje të kostove për buxhetin e Bashkisë duke paguar më pak.

Më pas fjalën e mori përsëri **z. Islami** i cili falenderoi edhe një herë publikisht të gjithë stafin e Bashkisë të përfshirë në këtë projekt për përkushtimin dhe seriozitetin e treguar gjatë kësaj kohe. Gjithashtu ai shtoi se po punohet për një marrëveshje me OSHEE lidhur me panelet diellore.

Si përfundim takimi u mbyll me dëshirën e mirë për të vazhduar në këtë projekt mjaft të dobishëm për qytetin e Përmetit.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska


SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Foto nga takimi:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK